



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM
Nr. 67 datë 06.11.2024

“PËR NJË NDRYSHIM NË VKB NR 8 DATË 31.01.2024 PËR NJË SHITESË PLANI DHE NDRYSHIM NË BUXHETIN E BASHKISË SHKODËR PËR “PROJEKTIN HOLD ON - NXITJA E AKSESIT NË MBËSHTETJEN E SHËNDETIT MENDOR PËR TË RINJTË”.

Këshilli Bashkiak Shkodër në mbledhjen e tij të datës 06.11.2024, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, në mbështetje të nenit 35 pika 1 shkronja “d”, nenit 54, të ligjit Nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar, nenit 20 pika 1 dhe 5, të ligjit Nr. 68/2017 “Për financat vendore”, i ndryshuar, të ligjit Nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; pika 190 e udhëzimit Nr. 9, datë 20.3.2018 të Ministrisë të Financave dhe Ekonomisë “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, të ndryshuar, udhëzimit Nr.10, datë 12.07.2024 “Për kontrollin, regjistrimin, përdorimin, rakordimin, raportimin dhe publikimin e fondeve të financimeve të huaja në kuadrin e marrëveshjeve ndërkombëtare”; udhëzimit nr.35, datë 21.09.2020 “Për kontrollin, regjistrimin, përdorimin, rakordimin, raportimin dhe publikimin e fondeve të financimeve të huaja në kuadrin e marrëveshjeve ndërkombëtare”, Rezoluta e miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë për Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm të Axhendës 2030 të shteteve anëtare të Kombeve të Bashkuara e datës 04.12.2017. Marrëveshja e programit Erasmus+ 2021-2027 e miratuar ndërmjet Agjencisë Kombëtare dhe Bashkisë Shkodër, ku Bashkia Shkodër ka rolin e palës zbatuese për zbatimin e Projektit “HOLD ON - Nxitja e aksesit në mbështetjen e shëndetit mendor për të rinjtë” me nr. 20713 Prot, datë 29.12.2023; VKB nr. 54 datë 30.09.2024 “Për miratimin e nivelit të pagave të funksionarëve të zgjedhur ose të emëruar, të nëpunësve civil të punonjësve administrativë të Bashkisë dhe institucioneve të varësisë”. VKB Nr. 55, Datë 29.12.2023 “Për miratimin e Buxhetit të vitit 2024 dhe Programit Buxhetor Afatmesëm Përfundimtar 2024-2026 të Bashkisë Shkodër” i ndryshuar, pas shqyrtimit të materialit të përgatitur nga Administrata e Bashkisë,

VENDOSI:

Në vendimin VKB Nr. 8 datë 31.01.2024 "Për një shtesë plani dhe ndryshim në buxhetin e bashkisë shkodër për "Projektin Hold On - Nxitja e aksesit në mbështetjen e shëndetit mendor për të rinjtë", bëhen këto ndryshime:

1. Pika 3 ndryshohet si më poshtë vijon:

Projekti do të zbatohet me llogari jashtë thesari dhe do të përfshihet në programin 10430 "Kujdesi social për familjet dhe fëmijët" sipas tabelës së mëposhtme.

Shpenzimet e llogaritura				
	Totali	Nga kjo:		
	(Lek)	Paga	Sigurim e shoq + shënd	Shpenzim e Operative
Shuma 2024	2,753,700	550,000	97,060	2,106,640
Shuma 2025	115,300	98,800	16,500	
Shuma totale e Projektit e financuar nga Projekti	2,869,000	648,800	113,560	2,106,640
Bashkëfinancimi i Bashkisë Shkodër	435,000			435,000
Totali	3,304,000	648,800	113,560	2,541,640

Pika 4 ndryshohet si më poshtë vijon:

2. Niveli i pagës do të jetë sipas tabelës së mëposhtme:
Ishte:

Emërtimi	Punonjës	I zgjedhur, I emëruar	Arsimi i lartë		Arsimi i mesëm	
			Kategoria	Pozicioni	Klasa	Paga Bazë Mujore
Specialist	1		IV-a	56,000		
Numri i Punonjësve	1					

Punonjësi do punojë me kohë të pjesshme me 60 % të kohës përgjatë gjithë kohëzgjatjes së projektit.

Bëhet

Emërtimi	Punonjës	I zgjedhur, I emëruar	Arsimi i lartë		Arsimi i mesëm	
			Kategoria	Pozicioni	Klasa	Paga Bazë Mujore
Specialist	1		IV-2	80,000		
Numri i Punonjësve	1					

Punonjësi do punojë me kohë të plotë duke filluar nga 1 Tetor 2024 deri në përfundimin e projektit.

3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
4. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit Nr.139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", i ndryshuar dhe i fillojnë efektet financiare me 1 Tetor 2024.

Miratuar me 28 vota

Vota Pro 28

Vota Kundër 11

Vota Abstenim 0

Zbardhur me datë 07.11.2024

SEKRETARE

Sabina Danaj

